1. Autoriteti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
  - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë përkatëse në procedurat me faza;
  - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
  - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
  - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit kontraktor ka ndryshuar;
  - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021.
3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

---

## SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1. Formulari i Ofertës .....	
Shtojca 2. Lista e Çmimeve të Shërbimeve .....	
Shtojca 3. Formulari i Sigurimit të Ofertës .....	
Shtojca 4. Lista e Informacionit Konfidencial.....	
Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike .....	
Shtojca 6. Formulari i shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit.....	
Shtojca 7. Termat e referencës	
Shtojca 8. Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve .....	
Shtojca 9. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit.....	
Shtojca 10: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit .....	
Shtojca 11 - Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraparak) .....	
Formulari 12 Formulari i Njoftimit të Fituesit (Në përfundim të afatit të ankimit)	
Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Paraparak)	
Shtojca	14:
Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Në përfundim të afatit të ankimit)	

---

## Shtojca1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

### FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomikshënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimetpër **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve tëShërbimevedhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
  - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
  - 2. Njoftimin e Kontrates;
  - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
  - 4. Specifikimet teknike, grafikun e realizimit, termat e referencës;
  - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
  - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
  - 7. Listat e Çmimeve tëShërbimeve.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

---

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë _____</b>	

**Shtojca2.***(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE****Data:** \_\_\_\_\_**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**  
\_\_\_\_\_**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë** (në rast BOE): \_\_\_\_\_**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Shërbimet në Formularin e grafikut të realizimit për Shërbimet duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për Shërbim. Shërbimet pa çmim do të konsiderohen si shërbime të paofruar dhe do të cojë në refuzimin e ofertës.

**Lista e Çmimeve**

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
<b>Shërbimi</b>	<b>Përshkrimi i shërbimi</b>	<b>Sasia</b>	<b>çmimi për njësi</b>	<b>Çmimi total për shërbim(3 x 4X)</b>	
1.					
2.					
3.					
4					
	<b>Çmimi total (Shërbimet)</b>				_____
<b>Çmimi Neto pa TVSH</b>					
<b>TVSH (%)</b>					
<b>Çmimi total me TVSH:</b>					
<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>					
<b>Nënshkrimi</b>					
<b>Vula</b>					



---

<b>Datë</b> _____	
-------------------	--

---

### Shtojca 3.

[ Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

### FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

\* \* \*

Procedura e prokurimit[lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi(nësezbatohet):Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr.Referencës në faqen e APP-se

\* \* \*

Duke iu referuar procedures së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë[emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedhadhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës se prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

---

#### **Shtojca 4.**

*(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)*

#### **Lista e Informacionit Konfidencial**

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

#### **VËMENDJE**

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### **Përfaqësuesi i Ofertuesit**

#### **Nënshkrimi**

#### **Vula**

## Shtojca 5.

[ Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti Kontraktor]

### FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeveobjekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Specifikimet teknike janë si më poshtë vijon:

#### **GRAMATURAT**

FASULE		PILAF		SUPE ME PERIME/PULE	
Fasule	100gr	Oriz	100gr	Lëng pule	70 gr
		Gjalpë	10gr	Perime të ndryshme/	70 gr
Qepë	10gr	Kripë	5gr	Pulë	
Lëng mishi		Lëng mishi		Domate të freskëta	30 gr
Salcë	5gr			Piper	3gr
Kripë	5gr			Kripë	5gr
Piper	3gr				

PURE ME QOFTE	
Pure	50 gr
Gjalpë	10 gr

Qumesht	150 ml
Mish	70 gr
Qepë	20 gr
Hudhra	25 gr
Kripë	5 gr

MAKARONA	
Spagetiosefusli	100gr
Dafine	2 gjethe
Hudhra	5 gr
Kripë	5 gr
Piper	3 gr
Qepë	20gr
Lëng mishi	
Salc dom	10gr
karota	10gr

GJELLE VERORE	
Perime Stinore	50 gr
Qepë	50gr
Domate	50gr
Speca	50gr
Kripë	5gr
Lëng mishi	
Vaj gatimi	50 ml

MISH ME QEPË	
Mish	50 gr
Qepë	50gr
Miell	20 gr
Kripë	5gr
Salcë	5gr
Leng mishi	
Hudhra	25gr
Miell	10gr
Vaj gatimi	50 ml

BURANI ME SPINAQ	
Oriz	100 gr
Mish	50gr
Spinaq	30 gr
Kripë	5gr
Piper	3gr
Majdanoz	5gr
Koper	5gr

MAKARONA	GJELLË ME LAKËR	
Spageti ose fusili 100 gr	Lakër 80 gr	
Gjalpë 30 gr	Salcë domatesh 10 gr	Vaj 20 gr
Salcë	Lëng mishi	Kripë 5 gr
Kripë 5 gr	Uthull 10 gr	Piper 3 gr
	Hurdha 5 gr	
	Qepë 20 gr	

<b>GJELLË PATATE,BIZELE,KARROTË</b>		<b>PASTIÇE</b>	
Bizele 20 gr		Spageti 100 gr	
Karota 20 gr	kripe 5 gr	Vezë 1 kokërr	kripe 5 gr
Patate 20 gr	pipe 3 gr	Qumësht 70 gr	
Salcë 10 gr		Djath i bardhe 50 gr	
Qepë 10 gr		Gjalpë 30	
Lëng mishi		Miell 20 gr	

<b>TURLI ME ZARZAVATE</b>	<b>GJELLË ME BAMJE</b>	
Perime të ndryshme stinore (spec,patellxhan,kunguj,patate,karrotetj) 30 gr secila	Bamje 80 gr	
Salcë 10 gr	Salcë domatesh 10 gr	Vaj 20 gr
Lëng	Lëng mishi	Kripë 5 gr
Qepë 10 gr	Uthull 10 gr	Piper 3 gr
Kripë 5 gr	Hurdha 5 gr	
Piper 3 gr	Qepë 20 gr	

<b>SALLATE FSHATI</b>
Domate 50 gr
Kastravec 50 gr
Qepë 10 gr
Vaj ulliri 5 ml
Kripë 5 gr

<b>BYREK</b>	
Peta	125 gr
Gjalpë	10 gr
Gjizë	30 gr
Vaj ulliri	30 gr
Erza	5 gr

<b>QOFTE ME LËNG</b>	
Mish	70 gr
Qepë	20 gr
Miell	10 gr
Vaj Gatimi	10gr
Kripë	5 gr
Gjalpë	5gr
Hudhër	5 gr

<b>BUKË</b>	<b>250 GR</b>
<b>FRUTA</b>	<b>100 GR</b>
<b>ËMBËLSIRË</b>	<b>100 GR</b>

#### **Ushqimi ditor do të përmbajë :**

- Pjatë e parë 200 gr
- Pjatë e dytë 200 gr
- Bukë 250 gr
- Fruta / ëmbëlsirë 100 gr
- Kos 200 gr

### **SPECIFIKIMET TEKNIKE PËR USHQIMIN**

#### **Bukë gruri**

##### **Specifikimet teknike:**

1. Buka e grurit do të prodhohet me miell i stazhinuar për një periudhë prej 10-30 ditësh. Mielli duhet të jetë i freskët, me ngjyrë, erë, shije dhe lagështirë konforme standarteve përkatëse të miellit. Mielli nuk duhet të ketë asnjë lloj lënde të huaj. Buka duhet të ketë formë të drejtë dhe normale, pa deformime dhe sipërfaqja e bukës duhet të jetë e lëmuar dhe pa plasje të ndryshme. Vëllimi i bukës duhet të jetë i mjaftueshëm. Shija, era, lagështira dhe aciditeti i bukës duhet të jetë konforme standartit teknik të prodhimit të saj.

---

-Korja e bukës – duhet të jetë e lëmuar, pa djegie, pa shkëputje të saj nga tuli, ngjyra e njellojtë, mjalti në të kuqerremtë, në të gjithë sipërfaqen.

-Tuli duhet të jetë i pjekur mirë, me porozitet të imët në të gjithë vëllimin e tij dhe nuk duhet të ketë gjurmë mielli të pabrumosura .Nuk pranohet bukë e shtypur, e deformuar, e papjekur, e djegur, me erë të huaj, me shije të hidhur e të thartë, me lendë të huaja, me lagështirë jo normale, me shije myku. Furnizimi i bukës do te behet jo me pak se 4 orë pas pjekjes. Amballazhi i transportimit të bukës duhet të jetë i pastër dhe të sigurojë mos dëmtimin e saj. Mjetet transportuese duhet të jenë të pastra, të mbyllura që të sigurohet transportim normal i bukës deri në destinacionin përkatës. Buka duhet të jetë e prerë në feta dhe e ambalazhuar në qese plastmasi.

### **Mish vici i freskët**

#### **Specifikimet teknike:**

1. Kërkohe mish gjedhi në rritje (**viçi**) Raca e tyre të jetë e ndryshme. Kërkohe cilësia e parë sipas standartit dhe vetëm kofshët e pasme.
2. **Pamja e jashtme:**
  - Sipërfaqja e jashtme të jetë e mbuluar me një cipë të hollë tharje.
  - Sipërfaqja e mishit të ftohur menjëherë pas prerjes të jetë i tejdukshem.
  - Tendinat te jenë të ndritshme, elastike dhe të forta.
3. **Ngjyra:** Mishi të jetë me ngjyrë rozë dhe i dhjamt të jetë me ngjyrë të bardhë.
4. **Konsistenca:** Te jetë e butë dhe elastike. Në prerje të duket kompakt.
5. **Palca e kockave :** Të mbushi të gjithë kanal in e palcës, ngjyra të jetë rozë në të verdhëe.
6. Çdo parti mishi shoqërohet me çertifikatën veterinare me të cilën vërtetohet gjendja e tij e mirë shëndetsore për shitje në treg (konsum).

### **Mish Pule**

#### **Treguesit cilësorë të kofshës së pulës:**

Pamja e jashtme: Me ngjyrë rozë e çelur që anon në të bardhë karakteristike e mishit të pulës së freskët, pa shtresa të tepërta dhjami, cilësi e parë.

Ndarja anatomike: Mishi i pulës do të përbëhet nga te gjithë pjeset e pulës (jo vetëm kofsha ose pjesë të tjera të ndara ).

.Kontrolli veterinar: Pulat shoqërohet me çertifikatën veterinare me të cilën vërtetohet gjendja e tij e mirë shëndetsore për shitje në treg (konsum).

### ***Perime të ndryshme***



---

**Domate:** Kërkohet domate e cilësisë së parë ,ku të jenë të freskëta,me forme tipike të kultivarit, të plota, të pastra, të pa vrara,te pa shtypura, pa kalbje dhe pa njolla nga diegia e diellit, të pa prekura nga sëmundjet dhe dëmtuesit si dhe të pa lagura.

-Pjekuria duhet të jetë normale ,me ngjyre te kuqe, lehtësisht roze dhe jeshile rreth bishtit.

-Nuk lejohen domate të tejpkjeka, të zbutura e të vyshkura.

-Dëmtime e sëmundje nuk lejohen.

**Patëllxhan:** Kërkohet cilësia e parë ,të jenë te freskët, të pastër, me sipërfaqje të lëmuar,me ngjyrë të zezë ne manushaqe,me pjekuri normale,me fletë jeshile me nuanca të dobëta manushaqe,te pa vyshkura.

-Dëmtime të ndryshme e sëmundje nuk lejohen.

**Qepë:** Kërkohet cilesia e parë ,të jetë me pjekuri të plotë, me cipë e bisht të thatë ,të shëndosha e të plota, me ngjyrë e formë tipike të kultivarit.

-Me sëmundje nuk lejohen.

-Të ngrira,të kalbura e të mykura nuk lejohen.

**Speci:** Kërkohet cilesia e parë, të jenë me formë e ngjyrë të kultivarit, të freskëta, të pastra dhe me pjekuri natyrale.

-Shija të jetë karakteristike e kultivarit. Lejohet shije djegëse e lehtë. Nuk lejohet perzierja e specave djegës me ato jo djegës.

**Lakra:** Kërkohet cilesia e parë ,të jene te zhvilluara,me mbeshtjellje fletesh,e fortë në prekje.Lejohen lakra të pa ngjeshura.

-Me semundje nuk lejohen.

**Spinaq:** Kërkohet cilesi e parë, i freskët , i njomë, i pastër me ngjyrë jeshile të errët, i pa vyshkur dhe i larë me ujë të pastër, i lidhur në dëngje të vogla deri në një kg .Gjethet të jenë të plota dhe pa njolla të ngjyrës së ndryshkut, pa dëmtime nga krimbat, pa dëmtime mekanike, të freskëta dhe të pavyshkuara.

**Preshi:** Kërkohet cilësia e parë ,të jetë i freskët,i njomë,i pastër ,me ngjyrë të bardhë e jeshile, i pa vyshkur dhe i larë me ujë të pijshëm. Dëmtime e sëmundje nuk lejohen.

---

**Sallata jeshile** Kërkohet cilësi e parë, e freskët , e njomë, e pastër me ngjyrë jeshile të celët deri në të errët, e pa vyshkur dhe i larë me ujë të pastër, me gjethe ti lidhur në rrënjë.

Të mos ketë dëmtime mekanike ,me gjethe të pa vrara karakteristike të varietetit.

**Karrota** . Kërkohet cilësi e parë, e freskët , e njomë, e pastër me ngjyrë petokalli e të jetë e pa vyshkur dhe e larë me ujë të pastër, me tufa te lidhura ne rrënjë .

**Patate :**

-Kërkohet cilësia e parë, të jetë e plotë ,të forta, të pastra e të thata, jo jeshile,jo të mbira me ngjyrë dhe me sytha tipike të kultivarit.

-Kokrra të jetë e pjekur.

-Nuk lejohen të gjelbëra, të vyshkura, të mbira, të çara e të prera, të kalbura, zgjebe në plagë, njolla bojë hiri e ndryshku, dëmtime nga krimbi, dëmtime nga dosa dhe të papastruara nga dherat.

**Bamja:**

-Kërkohet cilësia e parë ,të jetë e fortë dhe e qëndrueshme, të ketë ngjyrë të gjelbër e ndezur. Lëkura duhet të jetë e lëmuar pa dëmtime.

**Gjalpi freskët**

-Të jetë prodhim vendi me bazë qumësht lope vendi , delje ose dhie , i freskët.

-Ngjyra te jetë e verdhë karekteristike e gjalpiti të lopës ose e bardhë e karekteristike gjalpiti të dhisë dhe deles.

-Nuk lejohen përberës të tjerë, njolla të errëta karekteristike e gjalpiti jo të freskët.

-Shija të jete e këndshme , pa erëra të tjera jo natyrale

**Djathë i bardhë**

-Kërkohet cilësia e parë ,vendi , me bazë prodhim djathi në produkt i qumështit të lopës, deles, ose dhisë.

-Nuk lejohet prodhim i djathit me perzierje qumësht pluhur ose te kodensuar.

-Djthi të ketë kaluar periudhën e stazhionimit mbi 3 muaj

-Ngjyra të jetë sipas llojit të qumështit , djathë lope, në ngjyrë të qumështit (krem), i deles dhe dhisë të ketë ngjyrën karakteristike të qumështit ,( i bardhë kur djathi është prodhuar me bazë qumështi delje ose dhie , dhe ngjyrë kremi kur djathi është prodhuar nga qumështi i lopës )

-Sasia e kripës të jetë normale .

---

### **Qumësht i freskët**

-Kërkohet qumësht lope vendi .

-Qumështi të jetë prodhuar brenda ditës mundësisht nga mjelja e parë në mëngjes pasi dhe konsumi do të jetë ditor.

-Qumështi të ketë karakteristikat tipike të qumështit të lopës i cili ka ngjyre pak të verdhë, pa përberës të huaj dhe papastërti të tjera , i kulluar dhe i skremuar

-Nuk lejohet qumësht që ka kaluar mbi tre ore nga mjelja .

### **Kos i freskët**

Përbërja e Kosit: Kosi duhet të ketë një konsistencë të qartë dhe uniforme, pa formuar grumbuj ose të ketë lëng të tepruar.

Shija dhe Aroma: Kosi duhet të ketë një shije të freskët dhe acidike, me një aromë të lehtë të fermentuar që është karakteristikë për produktin.

Paketimi: Kosi duhet të paktohen në kushte higjienike dhe në materiale që mbrojnë produktin nga ndotja dhe dëmtimi. Paketimet duhet të jenë të mbyllura mirë për të ruajtur freskinë.

Produkti duhet të ruhet në temperatura të ftohta për të ruajtur cilësinë dhe sigurinë ushqimore.

### **Vezë**

- Vezët të jenë prodhim vendi dhe të stampuara ku të dallohet qartë origjina e mallit.
- Të jenë të vendosura në bikurina, të ambalazuara në kuti kartoni ku të jetë etiketuar prodhuesi, data e prodhimit dhe të jenë të vulosura nga prodhuesi mbi cdo kuti.
- Vezët duhet të kenë një afat skandence nga data e prodhimit vetëm 15 ditë.

### **Oriz**

- Treguesit shqisor: Pamja kokrra të shëndosha, të plota, të pastra e pa myk.Ngjyra e bardhë. Era pa shije të thartë pa erë myku.

### **Fasule**

- Treguesit shqisor: Pamja kokrra të shëndosha e të plota.
- Ngjyra e bardhë, shija pa erë myku,

### **Makarona**

- Treguesit shqisor: ngjyra e bardhë në të verdhë, pa shije të hidhur e të thartë, pa erë të huaj.

---

### **Vaj ushqimor**

- Treguesi i cilësisë:  
Ngjyra e verdhë në të lehtë.

Era dhe shija karakteristike e vajit të lulediellit, pa erë e shije të huaj.

### **Kripë ushqimore**

- Të jetë e cilësisë së parë ,
- Ngjyra: e bardhë me shkëlqim.
- Treguesit shqisor: me shije karakteristike të kripur, pa erë të huaj, me përdorim të njëtrajtshëm, e treteshme plotësisht në ujë.

### **Salcë domatesh**

- Kërkohej salcë domate e përpunuar me bazë vetëm domate , prodhim vendi ose i huaj.
- Ngjyra e salcës të jetë e kuqe e thellë.
- Shija të jetë e ëmbël pa shumë aciditet.
- Aroma të jetë e këndëshme në përputhje me aromën e domates së fresket karakteristike e llojit.

### **KËRKESA TË PËRGJITHSHME:**

- Objekti dhe qëllimi: Ofrimi i një vakti të ngrohtë ushqimor për kategorinë e njerëzve në nevojë pranë Qendrës Komunitare “Gonxhe Bojaxhi”
- Të sigurojë furnizimin në kohë dhe me cilësinë e kërkuar të ushqimit të gatuar.
- Të garantojë në çdo kohë shumëllojshmërinë dhe kaloritë e nevojshme sipas menuve të përcaktuara për personat që trajtohen me ushqim nga Institucioni ynë..
- Të sigurojë ushqim të sigurtë për mbrojtjen e shëndetit nga dëmtimet që mund të shkaktohen nga ushqimi.
- Të bëjë kompletimin e ambienteve me pajisjet e domosdoshme për furnizimin, përgatitjen dhe gatimin e ushqimit.
- Të sigurojë kushtet e nevojshme higjienosanitare për realizimin e shërbimit.
- Të sigurojë shërbim me standard të larta.

### **Kërkesat teknike për përgatitjen e ushqimit dhe sigurisë ushqimore:**

#### **1) Përgatitje e ushqimit dhe kërkesat higjieno-sanitare**

- Qendra Komunitare “Gonxhe Bojaxhi” trajton me një vakt (dreke) ushqimor, shtresat në nevojë nga dita e Henë dhe deri ditën e Shtunë. Ushqimi shërbehet pranë Qendrës në orën 12.00.

- 
- Operatori i kontraktuar, në bazë të kontratës, përgatit ushqimin për të gjithë sasinë e kërkuar, bazuar në menutë e përgatitura nga autoriteti kontraktor si dhe të verifikimit të forcës ditore nga institucioni.
  - Ambjenti i kuzhinës ku duhet të realizohet shërbimi i gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit do jetë në ambientet ne Pronesi / ose ne ambiente te marra me qera te Operatorit Ekonomik qe do te jete fitues ne perfundim te Procedurave te Prokurimit dhe lidhjes se Kontrates. Ambientet duhet të plotësojnë të gjitha kushtet higjeno-sanitare sipas akteve nën ligjore në fuqi.
  - Operatori i kontraktuar e transporton ushqimin e përgatitur nga kuzhina e tij deri në ambientet e Institucionit (mencë), për të gjithë sasinë e kërkuar ditore, me mjetet, pajisjet dhe enët e veta.
  - Shërbimi i shpërndarjes së ushqimit në mencën e institucionit do të realizohet nga punonjës të Institucionit tonë.
  - Operatori i kontraktuar përgatit racionet e ushqimit sipas listë menuse javore dhe ditore të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor.
  - Te gjithë artikujt ushqimore që do të përdoren për gatim do të jenë të cilësisë së parë, të freskëta, sipas specifikimeve teknike për lëndet e para të përcaktuara në këtë dokument.
  - Ushqimi të jetë i gatuar brenda ditës, racioni ditor duhet të përmbajë sasi të duhura të artikujve sipas listë menuse javore dhe ditore, ushqimi të shpërndahet i ngrohtë sipas orareve të përcaktuara nga Administrata e Qendres Komunitare Gonxhe Bojaxhi
  - Në asnjë rast nuk do të lejohet zevëndësimi i artikujve ushqimorë, që janë përcaktuar në normën bazë të ushqimit, me perjashtim të rasteve të fatkeqesive natyrore apo të fuqisë madhore.
  - Numri i personave që trajtohen me ushqim nga Autoriteti Kontraktor është rreth 100 persona ne ditë. Numri i saktë i forces ditore, që do të trajtohet me ushqim, plotësohen nga personi/personat e caktuar nga Autoriteti Kontraktor cdo ditë, brenda orës 09.00 dhe i njoftohet menjëherë personit përgjegjës për ushqimin të caktuar nga Operatori i Kontraktuar.
  - Personi/personat e ngarkuar nga Autoriteti Kontraktor, bazuar në fletët e forcës ditore, në fillim të cdo muaji, harton pasqyrën përmbledhëse me numrin e personave të trajtuar me ushqim për muajin paraardhës. Kjo pasqyrë, pasi rakordohet, firmoset nga përfaqësuesit

---

e të dy palëve dhe shërben si bazë për kryerjen e pagesës cdo muaj nga Qendra Komunitare “Gonxhe Bojaxhi” për operatorin e kontraktuar.

- Operatori i kontraktuar dorëzon ushqimin tek personi/personat përgjegjes për pritjen e mallit e ngarkuar nga Autoriteti Kontraktor dhe pas konfirmimit të sasisë dhe cilësisë së ushqimit të furnizuar, bëhet shpërndaja nga punonjësit tonë.
- Operatori kontraktuar përgatit ushqimin sipas menisë të miratuar nga Autoriteti kontraktor, për 1 (një) vakt në ditë (vakti i drekës). Shpërndarja bëhet nga punonjësit e Qendes Komunitare “Gonxhe Bojaxhi” në orën 12.00.
- Operatori kontraktuar duhet të zbatojë kërkesat e ligjit Nr.9863 date 28.01.2008 “Për Ushqimin” i ndryshuar, për furnizimin /shpërndarjen me produktet ushqimore në ambientet e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, si dhe për ruajtjen e higjienës dhe mjedisit , kushteve tekniko-teknologjike dhe personelit.
- Produktet e përdorura për përgatitjen e ushqimeve duhet të jenë në përputhje dhe në respektim të standardeve të kërkuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi konform manualit të vetëkontrollit HACCP.
- Transporti i ushqimit të përgatitur nga kuzhina e shërbimit të ushqimit social për kategoritë e shtresave në nevojë dhe deri te menca e institucionit, të realizohet me mjete,pajisje dhe enë të posaçme të llojeve dhe madhësive të ndryshme në funksion të sasisë që ofrohet si dhe për të ruajtur nivelin kulinar të ushqimit (e rëndësishme është ruajtja e temperaturës sipas llojit të produktit ).
- Produktet ushqimore (lënda e parë) që do të përpunohen, trajnohen apo ambalazhohen në ambientet e përpunimit ( kuzhinës ) që disponon sipërmarrësi të jenë të shoqëruara me fletë analize përkatës.
- Operatori ekonomik të respektojë rregullat e higjienës për larjen, pastrimin dhe përpunimin e zarzavateve,frutave sipas kërkesave të ligjeve në fuqi në fushën e higjienës dhe ushqimit.
- Operatori për qëllime higjene dhe pastrimi të përdorë detergjent dhe solucione kimike të certifikuar nga institucione e njohura me ligj dhe të padëmshme për shëndetin e njerëzve të përcaktuara sipas akteve në fuqi (Urdhër Nr.365 dt.03.08.2012 I MSH “ Për miratimin e listës dhe përdorimin e lëndëve që përdoren për dezinfektim, deratizimit, dezinfektim në shëndetin publik).

- 
- Operatori ekonomik duhet të sigurojë një higjencë të përditshme në mbajtjen e pajisjeve të kuzhinës, ambienteve të gatimit ,atyre të ndarjes së ushqimit dhe menceve.
  - Operatori ekonomik duhet të realizojë larjen dhe dezinfektimin e enëve dhe pajisjeve që përdoren.
  - Pastrimi i inventarit të imët kryhet nga operatori ekonomik i cili duhet të mbajë edhe regjistrat e pastrimit.
  - Në rast të sëmundjeve infektive të përdoren për shpërndarjen të ushqimit vetëm pajisje të veçanta dhe njëpërdorimshme.
  - Operatori ekonomik do të paketojë dhe të evakujë çdo ditë mbeturinat që krijohen si rezultat i prodhimit, shpërndarjes dhe konsumit të ushqimit në vendet e caktuara si vend grumbullimi mbeturinash.
  - Materiali në kontakt me ushqimin (termuset, enët, etj ) me të cilat transportohet ushqimi të jenë material i përshtatshëm dhe lehtësisht të pastrueshëm, sipas kërkesave të Udhëzimit të Ministrisë të Bujqësisë Nr.22 datë 25.11.2010 “Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të higjienës për stabilimentet e ushqimit dhe operatorët e biznesit ushqimor” me mbyllje hermetike ( për të siguruar mbrojtjen nga mjedisi i jashtëm). Enët që përdoren për transportin dhe/ose shpërndarjen e ushqimit duhet të jenë me material jo të dëmshëm për shëndetin .
  - Punonjësit e operatorit ekonomik në momentin e përgatitjes/shërbimit të ushqimit në ambientet perkatëse, duhet të jenë pajisur me uniformën, veshjen perkatëse të punës (përparëse, grykëse, këpucë, pantallona) këta të fundit të jenë të pajisur me librezë shëndetësore .
  - Operatori ekonomik duhet që në çdo kohë të shoqërojë ushqimin e gatuar me dokumentacionin perkatës deri në konsumimin e plotë të tij dhe të garantojë sigurinë e produktit nëpërmjet gjurmueshmërisë së tij sipas VKM Nr.760 datë 16.09.2015 “ Per kërkesat për gjurmimin e ushqimit dhe ushqimit për kafshë përgjatë zinxhirit ushqimor”dhe analizat e ujit që përdor .
  - Operatori ekonomik është i detyruar të ruajë në raftet të veçanta në mjedisin e kuzhinës, kampionet e ushqimit të gatuar e që shpërndahet për ngrenie për të gjitha vaktet. Afati i ruajtjes së mostrave ( kampioneve ) është 24-orë. Kur ka denoncime për cilësinë e ushqimit ky afat zgjat deri në zgjidhjen e problemit dhe kryerjen e analizave laboratorike.

- 
- Operatori ekonomik do të mbulojë shpenzimet ekonomike të nevojshme për realizimin e analizave laboratorike të mostrave të ushqimit gatuar, sa herë që kërkohet nga autoriteti kontraktor .

## **2.Menaxhimi nga Autoriteti Kontraktor**

Të verifikojë për vaktin e drekës numrin e personave që trajtohen me ushqim (forca ditore) te detajuar:

- a. Numri i personave që trajtohen me nje vakt.
- b. Autoriteti Kontraktor te kontrollojë e ti kërkojë operatorit ekonomik respektimin e orarit të gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit, zbatimin e normave të racioneve të ushqimit, si dhe pastërtinë në ambientet e gatimit të ushqimit dhe të shpërndarjes së ushqimit.
- c. Autoriteti Kontraktor, të mos lejojë operatorin ekonomik që të përdorë pajisje për gatim dhe inventarë te imët për shpërndarjen e ushqimit jashtë specifikimeve të kërkuara në këtë shkresë dhe dokumentet standarde të tenderit.
- d. Operatori i kontraktuar dorëzon ushqimin tek personi/personat përgjegjës për pritjen e mallit e ngarkuar nga Autoriteti Kontraktor dhe pas konfirmimit të sasisë dhe cilesisë së ushqimit të furnizuar, bëhet shpërndaja nga punonjësit tanë.
- e. Personi/personat e ngarkuar nga Autoriteti Kontraktor, bazuar në fletët e forcës ditore, në fillim të cdo muaji, harton pasqyrën përmbledhëse me numrin e personave të trajtuar me ushqim për muajin paraardhës. Kjo pasqyrë, pasi rakordohet, firmoset nga përfaqesuesit e të dy palëve dhe shërben si bazë për kryerjen e pagesës cdo muaj nga Qendra Komunitare “Gonxhe Bojaxhi” për operatorin e kontraktuar.

Operatori ekonomik duhet të ketë inventarin e nevojshëm për ruajtjen, përpunimin, gatimin, dhe shpërndarjen e ushqimit, për një grup personash prej 100 veta për vaktin e drekës, sipas orareve të përcaktuara.

1. Tabaka -- 100 copë
2. Lugë gjelle –100 copë
3. Lugë ëmbëlsire – 100 copë
4. Piru – 100 copë
5. Tas per supen –100 copë
6. Pjatanca – 50 copë
7. Pjata gjelle –100 copë
8. Pjata të vogla -100 copë
9. Pjata ëmbëlsirash 100 copë
10. Gota uji – 100 copë
11. Mushama
12. Kartopeceta
13. Ndarëset e ushqimit (garuzhde , kapse etj)
14. Qese mbeturinash



---

## Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

### FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

#### SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT

##### MENU E USHQIMIT

##### Menu Dimërore

##### MENUTË JAVORE

##### Java e I-rë dhe e III-të

	<b>E HËNË</b>	<b>E MARTË</b>	<b>E MËRKURË</b>	<b>E ENJTE</b>	<b>E PREMTE</b>	<b>E SHTUNË</b>
<b>1</b>	Fasule	Supë perime	Gjellë me patate	Jani (Mish me Qepe)	Burani me spinaq	Supë pule
<b>2</b>	Pilaf	Makarona	Byrek	Pilaf	Byrek	Makarona
<b>3</b>	Kos	Kos	Kos	Kos	Kos	Kos
<b>4</b>	Bukë	Bukë	Bukë	Bukë	Bukë	Bukë
<b>5</b>	Ëmbëlsirë	Fruta	Ëmbëlsirë	Fruta	Ëmbëlsirë	Fruta

##### JAVA E II-te DHE IV-ër

NR	E HËNË	E MARTË	E MËRKURË	E ENJTE	E PREMTE	E SHTUNË
1	Gjellë me lakër	Gjellë me patate bizele karrote	Burani me spinaq	Fasule	Jani (Mish me qepë)	Supë pule
2	Pilaf	Byrek	Pastice	Pilaf	Byrek	Makarona
3	Kos	Kos	Kos	Kos	Kos	Kos
4	Bukë	Bukë	Bukë	Bukë	Bukë	Bukë
5	Ëmbëlsirë	Fruta	Ëmbëlsirë	Fruta	Ëmbëlsirë	Fruta

## Menu Verore

### Java e I-rë dhe e III-të

	E HËNË	E MARTË	E MËRKURË	E ENJTE	E PREMTE	E SHTUNË
1	Qofte me lëng	Supë Perime	Gjellë me bamje	Barbunja me mish	Gjellë verore	Supë Pule
2	Byrek	Patate Furre	Pilaf	Makarona	Sallat fshati	Makarona
3	Tarator	Kos	Kos	Kos	Kos	Kos
4	Bukë	Bukë	Bukë	Bukë	Bukë	Bukë
5	Fruta	Ëmbëlsirë	Fruta	Ëmbëlsirë	Fruta	Ëmbëlsirë

### JAVA E II-të DHE IV-ër

NR	E HËNË	E MARTË	E MËRKURË	E ENJTE	E PREMTE	E SHTUNË
1	Supë perime	Qofte me pure	Fërgesë	Turli me zarzavate	Gjelle me bamje	Supë pule
2	Fruta	Byrek	Fruta	Makarona	Pilaf	Makarona
3	Kunguj me kos	Kos	Tarator	Kos	Kos	Kos
4	Bukë	Bukë	Bukë	Bukë	Bukë	Bukë
5	Ëmbëlsirë	Fruta	Ëmbëlsirë	Fruta	Ëmbëlsirë	Fruta

Menuja është përcaktuar e ndarë në verore dhe dimërore për arsye të frutave dhe perimeve stinore. Muajt (Mars-Gusht) si Menu Verore, dhe Muajt (Shtator-Shkurt) si Menu Dimërore.

**Vendi i kryerjes së shërbimeve: Qendra Komunitare “Gonxhe Bojaxhi”, Bashkia Tiranë.**

**Sasia e mallit që kërkohet:**

Artikulli	Përshkrimi	Njësia	Shuma	Destinacioni	Periudha e dorëzimit
1	Vakt ushqimor (dreka)	racion	31 300	Qendra Komunitare “Gonxhe Bojaxhi”	12 muaj marrëveshje kuadër

**Afatet e ekzekutimit: Duke filluar nga data e lidhjes së kontratës/kontratave me përfundim deri në plotësimin e nevojave të autoritetit kontraktor sipas marrëveshjes kuadër.**

---

## Shtojca 7

( Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

### **TERMAT E REFERENCES**

**Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:**Ofrimi i një vakti të ngrohtë ushqimor për kategorinë e njerëzve në nevojë nga dita e Hënë deri ditën e Shtunë.

#### **Detyrat:**

Të gjithë artikujt ushqimorë që do të përdoren për gatim do të jenë të cilësisë së parë, të freskëta, sipas specifikimeve teknike për lëndët e para të përcaktuara në këtë dokument. Ushqimi të jetë i gatuar në çast, racioni ditor të përmbajë sasitë e duhura të artikujve sipas listës së menusë javore dhe ditore,ushqimi të shpërndahet i ngrohtë sipas orareve të përcaktuara nga Administrata e Qendrës Komunitare "Gonxhe Bojaxhi".

Në asnjë rast nuk lejohet zëvendësimi i artikujve ushqimore,që janë përcaktuar në normën bazë të ushqimit, me përjashtim të rasteve të fatkeqësive natyrore apo të fuqisë madhore.

Personeli që do të realizojë procesin e prodhimit të ushqimit, të ketë kualifikimin e nevojshëm profesional, si dhe të jetë pajisur me librezë shëndetësore.

**Shpërndarja:**Ushqimi duhet të vijë nga e hëna në të shtunë në ambientet e Qendrës Komunitare "Gonxhe Bojaxhi".

**Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve:**Qendra Komunitare "Gonxhe Bojaxhi", Bashkia Tiranë.

**Rruga "Selaudin Bekteshi, Njësia Administrative nr.4, Tiranë**

---

## Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

### FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

#### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale; dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

---

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

### **Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës3;*

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

1. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë Licencë të kategorisë “II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz” të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit. Në zbatim të rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018 nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik. Për këtë arsye detyrimisht Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i licensuar sipas dispozitave perkatëse ligjore dhe nën ligjore.

#### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit**. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

2. Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për Vitin 2024 (ku të përfshihet kësti për periudhën perkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar), duke paraqitur një vërtetim nga organet e qeverisjes vendore ku ushtron aktivitetin. Në rast bashkimi operatorësh

---

ekonomikë, vërtetimin nga organet e qeverisjes vendore duhet ta ketë secili subjekt më vete.

**Sqarim:** Ky kriter do të plotësohet nepermjet formularit të vetdeklarimit sipas shtojces 8 të DST. Në zbatim të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.*

### 2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e publikimit të njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:
  - a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.
  - b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.
2. Operatori Ekonomik duhet të vërtetoj se disponon 1 (një) ambient, ku ushtron veprimtarinë e shërbimit dhe gatimit të ushqimit, për të cilin duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
  - **Dokumentacioni që vërteton pronësinë:**
    - Çertifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj ose kontrata e shitblerjes ose kontrata e dhurimit ose çdo dokument tjetër me anë të së cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.
  - **Dokumentacioni që vërteton huapërdorjen:**
    - Kontratë noteriale huaje (e vlefshme)
  - **Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira:**
    - Kontratë noteriale qiraje (e vlefshme)

**Shënim 2.1:** Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku të deklarohet plotësimi i kushteve higjieno - sanitare dhe tekniko-teknologjike për ambientin ku ushtron veprimtarinë e shërbimit dhe gatimit të ushqimit.

3. Operatori ekonomik duhet të disponojë minimumi 1 (një) mjet transporti frigoriferik, për transportin e produkteve ushqimore, në pronësi ose me qira ose huapërdorje, sipas tabelës se mëposhtme:

Nr	Lloji i mjetit	Targa e mjetit	Statusi
1			Në pronësi/me qira/huapërdorje

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin prane AK dokumentacion per mjetin e mësipërm, që vërtetojnë pronësinë, qiranë, ose huapërdorjen, (certifikate pronësie/ kontrata noteriale qiraje (e vlefshme) / kontrata noteriale huapërdorje (e vlefshme) mjeti si dhe çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë) si dhe lejen e qarkullimi të mjetit, siguracion mjeti të vlefshëm dhe Kolaudim mjeti te vlefshem.

**Mjetet qe do te deklarohen, detyrimisht do ti paraqiten Autoritetit Kontraktor per te gene pjese e planit te zbatimit te kontrates.**

